



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal of Kacanik
01 Nr. 104/02-27046/24
Kaçanik, 30.10.2024

Në bazë të nenit 12.2 (d) lidhur me nenin 17 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/4 Qershor 2008), të nenit 5 pika 3.5 dhe 3.2 të Ligjit Nr. 03/L-025 - për Mbrojtjen e Mjedisit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 50/06 Prill 2009), të Ligjit për Ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147, të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës 03/L-233, të Ligjit për Pyjet e Kosovës 03/L-153, të Ligjit për Mbeturina 04/L-060, të Ligjit Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja 08/L-025, të Ligjit për Mbrojtje nga Zhurma 02/L-102, të nenit 6.2 të Statutit të komunës së Kaçanikut, me Propozim të drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit në konsultim me Kryetarin e Komunës, duke vendosur sipas kërkesës së Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës Nr. 6483-2/24 për rishqyrtimin e ligjshmërisë së aktit, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me 30 tetor 2024, mori këtë:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT NË MJEDIS ME VEPRIM KLIMATIK I KOMUNËS SË KAÇANIKUT 2025-2029

1. Me këtë Vendim, MIRATOHET Plani i Veprimit në Mjedis, me veprim klimatik, i komunës së Kaçanikut, 2025-2029.
 2. Plani i Veprimit në Mjedis, është realizuar në kuadër të projektit 'Shijoni lumenjtë e pellgut të Lepencit' i zbatuar nga Organizata për Mbrojtjen e Mjedisit Gjethi, i financuar nga IWRM-K dhe Komuna e Kaçanikut. IWMRK-K është Programi i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Qeverisë së Kosovës i cili zbatohet nga Skat Consulting (Zvicër) në konsorcium me Agjencinë e Mjedisit Austria (EAA).
 3. Plani i Veprimit në Mjedis nga pika 1 e këtij vendimi, është hartuar si kontribut i grupit punues me vendim të Kryetarit të Komunës me Nr. 01Nr. 104/02-9929/23, përmban 64 faqe dhe i njëjti është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
 4. Me marrjen e këtij vendimi, Anulohet Vendimi i Kuvendit të Komunës për Aproximin e Planit të Veprimit në Mjedis 01Nr.060/01-22876/24 i datës 30.09.2024, për shkak të disa lëshimeve teknike.
 5. Për zbatimin e këtij Vendimi do të përkujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe mekanizmat tjerë relevantë.
 6. Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores (MAPL) Nr.01/2017- për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës.
- Me këtë Vendim njoftohen:** Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit (përmes kësaj drejtorie njoftohen mekanizmat tjerë relevantë), Arkivi,





REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Data	21.11.2024	Vendi	Kaçanik
Nj. org.		Numri	
		Shtojcë	
01-060/01-29501/24			



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	7389-2/24
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure	
Prishtinë / A	
21.11.2024	
020-622/14	

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Për:	Besim Ilazi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Liburn Aliu, Ministër i MMPHI Afrim Murati, U.D Sekretar i Përgjithshëm në MMPHI
Nga:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor
Zyrtarët përgjegjës:	
1.Zyrtari konfirmues vlerësimit ligjor	Shendrita Latifi - zyrtare ligjore në Divizionin për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit të
2.Zyrtari hartues vlerësimit ligjor	Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit
Lloji i aktit:	Vendimi 01 Nr. 104/02-27046/24 për miratimin e planit të veprimit në mjedis me veprim klimatik i Komunës së Kaçanikut 2025 - 2029, miratuar nga Kuvendi Komunal i Kaçanikut, datë 30.10.2024

I nderuar kryetar Ilazi,
I nderuar kryesues Murseli

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me datë 08.11.2024 ka pranuar nga MAPL Vendimin 01 Nr. 104/02-27046/24 për miratimin e planit të veprimit në mjedis me veprim klimatik i Komunës së Kaçanikut 2025 - 2029, miratuar nga Kuvendi Komunal i Kaçanikut, datë 30.10.2024.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë dhe në pajtim me Nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave:

KONFIRMON

Vendimin 01 Nr. 104/02-27046/24 për miratimin e planit të veprimit në mjedis me veprim klimatik i Komunës së Kaçanikut 2025 - 2029, miratuar nga Kuvendi Komunal i Kaçanikut, datë 30.10.2024.

ARSYETIMI

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të Vendimit të shënuar më lartë, konstatoi se:

Ky vendim është në pajtim me Ligjin Nr.08/L-025 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja dhe aktet tjera ligjore në fuqi.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës mbetet në dispozicion të Komunës së Kaçanikut dhe MAPL-së për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.

